



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE DHE HOTELERI – TURIZËM
“ANTONI ATHANAS” SARANDË

Nr. 112 Prot.

Sarandë, më : 13. 11 2024

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele.

Drejtuar: Drejtorisë Juridike

✓ Drejtorisë Burimeve Njerezore

✓ Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit 7961 date 12/07/1995 “ Kodi I Punes ne Republiken e Shqiperise , ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit **Nr. 759, datë 30.09.2024**”Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njesisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit”, “ Shkolla e Mesme Profesionale : “Antonio Athanas”, Sarandë , ju njofton për krijimin e dy vendeve të lira pune në bazë të Urdhërit nga MEKJ nr.49 datë 12.07.2024 me Nr.966/1Prot date 12.02.2024(për dy mësues me kohë të pjesshme) në pozicionin “Mësuese e kulturës profesionale” në profilin mësimor 2-vjecar pas të mesmes “Ndërmjetësimin e Pasurive Të Paluajtshme” Aplikanti duhet të përmbushë këto kriterë:

1. Kriteretë të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të

2. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional / shkencor (profili Ekonomik) ose të barazvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;
- Jetëshkrimin (CV-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit **nr. 759, datë 30.09.2024**)
- Kartën e identitetit;
- Diplomën;
- Librezën e punës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 26.11 .2024 .



Drejtori
Rudina Liçaj